



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P.526/2017

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 17.07.2017 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Ferit Myftari” p.f nga procedura e prokurimit “*Kërkesë për propozime*”, me Nr. REF-11777-05-09-2017, me objekt “Blerje rroba pune”, me fond limit 1.619.000 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 26.05.2017 nga autoriteti kontraktor, Ujësjetllës-Kanalizime Vlorë ShA .

Ankimues: Ferit Myftari, person fizik (p.f)
Lagjia “18 shtatori”, Gjirokastër.

Autoriteti Kontraktor: Ujësjetllës-Kanalizime Vlorë ShA
Lagjia “Kushtrimi”, Rruga Arkobaleno, Vlorë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë, 29.12.2014 “*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “*Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, pretendimet e tij dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky operator i ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues.



II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 10.05.2017 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Kërkesë për propozime”, me Nr. REF-11777-05-09-2017, me objekt “Blerje rroba pune”, me fond limit 1.619.000 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 26.05.2017 nga autoriteti kontraktor, Ujësjiellës-Kanalizime Vlorë ShA.

II.2. Në datën 26.05.2017 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 29.05.2017 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- “Muça” shpk	nuk ka paraqitur ofertë	
- “Ferit Myftari” p.f	1.214.400 lekë	I skualifikuar
- “Blerina Kapedani” p.f	1.384.540 lekë	I kualifikuar
- “Moena al 66” shpk	1.460.700 lekë	I skualifikuar
- “Trinity Trade Company” shpk	1.543.000 lekë	I skualifikuar

II.4. Në datën 29.05.2017 operatori ekonomik “Ferit Myftari” p.f, është njoftuar për skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

“Operatori ekonomik nuk ka mundur dot te vertetoje :

-piken 2 te kapacitetit teknik ku kerkohet nga operatori ekonomik nje deklarate me shkrim qe furnizimi I materialave te realizohet nga operatori ekonomik sipas grafikut zyrtar te Sh.A Ujesjelles Kanalizime Vlore. Operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnje document/deklarate per te vertetuar kete pike te kapacitetit teknik.

- piken 3 te kapacitetit teknik ku kerkohet qe operatori ekonomik te paraqesi dorazi nga nje moster per secilin ze, ne daten dhe oren e hapjes se ofertave. Mostrat e paraqitura nga operatori ekonomik nuk jane sipas specifikimeve teknike te kerkuara nga Autoriteti Kontraktor konkretisht si me poshte :

-pika 2 e tabelës ku kerkohen veshje pune pantallona dhe xhakete nuk jane materiale cilesore pampuk sic eshte kerkuara nga AK-ja por mushama dhe jo cilesore, pra jane jashte kriterëve dhe specifikimeve teknike.

-pika 11 e tabelës se mostrave ku kerkohen cizme polumbari, nuk jane sipas directives CE per mbrojtjen individuale 89/686/EEC dhe nuk permbush standartet europiane EN ISO 20345:2011, nuk jane te certifikuar SARTRA TECHNOLOGY INERTE dhe nuk jane rezistente nga impakti godites deri ne 200 joules. Cizmja e polumbarit e sjelle si moster nga operatori ekonomik eshte material i dobet plastik i cili perthyhet lehte me dore dhe eshte evidente nje material i dobet qe nuk permbush asnje nga kriteret e percaktuar nga Autoriteti Kontraktor. Keto mangesi ne mostra jane dokumentuar edhe ne procesverbalin e hapjes se mostrave dt.26.05.2017 nr.589 prot, ku operatori ekonomik ka pranuar keto mangesi ne mostra duke firmosur ne fund procesverbalin e mbajtur”.

II.5. Në datën 30.05.2017 operatori ekonomik “Ferit Myftari” p.f., ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar arsyet e skualifikimit të tij të dhëna nga autoriteti kontraktor. Konkretisht ankimuesi në ankesën e tij pretendon si më poshtë:

“Konsiderojme teresisht te padrejte arsyen e skualifikimit , te preten duara nga ana juaj. Per kete qellim , po ju bejme te qarta me poshte arsyet perse ju jeni ne kundërshtim dhe ne shkelje te hapur te Ligjit Nr. 9643 dt.20.11.2006 "Per Prokurimin Publik" i ndryshuar, dhe V.K.M . Nr. 914 dt. 29.12.2014 "Per rregullat e Prokurimit Publik", i ndryshuar.

1- Pretendimi se nga ana e OE "FERIT MYFTARI " nuk eshte dorezuar nje deklarate per permbushjen e detyrimit per dorezimin sipas grafikut te kerkuar nga AK, eshte I pavertete. Nga ana e OE "FERIT MYFTARI", eshte dorezuar shtojca me deklaratat, ku nder te tjera eshte dhe deklarata per permbushjen e specifikimeve teknike dhe deklarata per permbushjen e kerkesave te tjera shites te AK. Gjithashtu, ne Formularin e Ofertes, ne fund te tij, OE ka deklaruar se u permbahet te gjitha kerkesave te AK. Pra rezulton se nuk eshte e vertete se nuk jane dorezuar dokumentacionet e kerkuara, nga ana e OE, duke rrezuar pretendimin tuaj.

2- Arsyeja se nuk jane paraqitur mo­strat nga ana e OE, se pari rrezohet nga vete deklarimet tua a dhe Pro­cesverbali i mbajtur po nga ana e juaj, i cili verteton se OE ka dorezuar mo­strat e kerkuara nga ana e juaj.

Pavaresisht kesaj, ne vetvete kjo kerkese perben shkelje te hapur te barazise ne tendera, e cila fillimisht duket qe ne shtojcat e jashteligjshme te bera nga ana e Juaj, jashte afateve dhe paketes standarte te Dokumentave te Tenderit.

Pavar sisht kesaj, nga OE jane dorezuar mo­strat ne ditën dhe oren e caktuar nga ana juaj. Por ju vazhdoni akoma ne parregullsite dhe shkeljet e ligjit, duke s'kualifikuar OE "FERIT MYFTARI" me pretendimin se dy nga mo­strat e dorezuara nuk jane te pelqyeshme nga ana e komisionit te vleresimit te mo­strave.

3. Ne Dok umentat Standarte te Tenderit, ne shtojcen e vecante te pasqyruar nga ana e juaj, keni shtuar pikat 3 dhe 4 ne te cilat keni vendosur kerkesa joligjore, por qe cuditerisht ne asnje vend nuk theksoni se nese mo­strat nuk do t'i pelqejne komisionit te vleresimit te mo­strave , ato do te refuzohen se bashku me oferten e OE. Pra ju keni kerkuar mo­strat, te cilat jane sjelle nga OE ne datën dhe oren e caktuar.

Pra perfundimisht, ju jeni teresisht ne shkelje te ligjit, duke skualifikuar OE I cili ka dorezuar dokumentacionin sipas kerkeseve tuaja, me kerkesa dhe shtojca qe jane joligjore dhe qe nuk jane te shkruara ne asnje paragraf te dokumentacionit te publikuar nga Autoriteti Kontraktor. Qe ne momentin qe OE, deklaroi me shkrim se permbush te gjitha specifikimet teknike te vendosura nga AK, vazhdimesia e procedures ka te beje me percaktimin e termave te kontrates qe do te lidhet me OE. Nese termat e percaktuara nga ana e juaj nuk zbatohen nga OE sipas kontrates, atehere ju lind e drejta te penalizoni OE.

Per sa me lart, ju bejme me dije se skualifikimi i OE "FERIT MYFTARI", eshte teresisht joligjor dhe i parregullt. Per kete arsye kerkojme rishikimin e vendimit te KVO dhe kualifikimin e OE, pasi jane plotesuar te gjitha kerkesat, ashtu si kerkohet ne DST".

II.6. Në datën 31.05.2017, me shkresën nr. 339 prot, operatori ekonomik ankimues “Ferit Myftari” p.f është vënë në dijeni në lidhje refuzimin e ankesës nga ana e autoritetit kontraktor.

II.7. Në datën 06.06.2017 operatori ekonomik ankimues “Ferit Myftari” p.f ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese drejtuar autoritetit kontraktor.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr.377 prot, datë 13.06.2017 protokolluar me tonën me numër 1059/2, datë 16.06.2017 është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e palës ankimuese “Ferit Myftari” p.f” mbi skualifikimin e ofertës së tij me arsyetimin se *“mostrat e paraqitura nuk janë në përputhje me specifikimet teknike bashkangjitur preventivit të publikuar”* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në Kreun II “Udhëzime për operatorët ekonomikë”, Seksioni 1 i “Hartimi i ofertës” i dokumentave standarte të tenderit parashikohet shprehimisht:

“Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme”.

III.1.2. Në shtojcën 7 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit”, Kapaciteti Teknik, pika 3, të dokumentave të modifikuara të tenderit të procedurës objekt ankimi, nga autoriteti kontraktor është kërkuar:

“3. Per te gjithë zerrat e artikujve objekt i prokurimit, operatorët ekonomik duhet te paraqesin dorazi nga nje moster per seicilin ze, ne datën dhe oren e hapjes se ofertave. Mostrat duhet te sillen tek AK te shoqeruara me shkrese përcjellëse me inventar, e vulosur dhe e firmosur nga Administratori i operatorit ofertues. Cdo perfaqesues i O.Ek qe do te dorezoj mostrat duhet te jete i pajisur me autorizim nga Administratori i Op.Ek. KVO do te beje hapjen dhe vlerësimin e mostrave ne datën dhe oren e hapjes se ofertave, ne prezence te gjithë Op.Ofertues. Mosparaqitja e mostrave është kusht skualifikues.”.

III.1.3. Në shtojcën 9 “Specifikimet Teknike ” të dokumentave standarde të procedurës së prokurimit objekt ankimi, nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar:

“Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

1. Jelek pune me shirita fosforeshente



Jeleku I punes te jete I përbere nga material 100% Poliester. I përshtatshme për punime ne ambjent te jashtem. Me shirit 5cm fosforeshent ne pjesen e përparme dhe ne pjesen e pasme, per te bere te mundur parandalimin e aksidenteve te papritura gjate punes tuaj ne kantiere apo rruge

Materiali : Poliester

Përmasa :

Ngjyra :

2. Maske mbrojtese me valvul niveli mbrojtjes FFP1



Maska FFP1 me valvul dhe filtër , mbrojtjen per frymëmarrjes e Niveli i mbrojtjes FFP1: Mbrojtje te mire per agjentet e ngurte dhe te lenget .

Materiali : Pambuk

3. Kaske pune sigurie Materiali:Plastik PE



Aftësia mbrojtese: Kundra carjeve,absorbimi i goditjeve, anti-shok, peshe e lehte, fortësi e rezistence te larte. Pesha e skeletit: 300gr Pesha e veshjes se brendshme: 90gr 4 pika fiskuese, mënyrë manuale e rregullimit ne pjesen e rripit te kokes .

Materiali : PE (specifikim teknik).

4. Kominoshe pune me rripa 65% poliesther 35% pambuk



Uniforma e punes me rripa me ngjyre gri e përbere nga material 65% Pambuk dhe 35% Poliesther, te jene me xhepa anash dhe ne pjesën e gjoksit.

Përmasa :

Materiali : Poliesther/Pambuk

Ngjyra :

5. Kepuca e sigurise

Prodhuar nga lekure lope ngjyre e zeze, rezistences ndaj vajrave, acideve dhe absorbimit te ngarkesave elektrike, Kepucet te pajisura me shtrese metalike ne pjesen e poshtme dhe pjesen e perparme duke i ofruar kembes nje mbrojtje maksimale kunder demtimeve gjate punes, me veshje te bredshme (Sfungjer) Prodhuar sipas standartit CE EN20345-1 S1P

Materiali : Lekure/Celik

Përmasa :

6. Doreze pune profesionale Materiali: Lekure, Ngjyra gri/verdhe

Dorezat profesionale , lëkure kamoshi të përshtatshme për një shumëllojshmëri të nevojave në natyrë dhe të punës. Dorezat duhet te jene te lehta, të qëndrueshme lëkurë per te ofruar shkathtësi dhe rehati.

Materiali : Lekure

Ngjyra :

7. Doreza Pune me veshje gome

Doreza pune me material pambuku te veshura me gome, te perdorshme për tu mbrojtur nga mjetet e forta gjate punes dhe te kenë elasticitetit

. Materiali : Pambuk/PVC

Ngjyra :

8. Cizme pune, shiu, te shkurtra, Materiali PVC



Cizmet e shkurtra prodhuar nga nje material PVC, ngjyre jeshile, jane te pa depertueshme nga uji.

Materiali : PVC

Ngjyra :

Rezistent ndaj ujit : PO

9. Cizme shiu te gjata, , Materiali: PVC

Cizmat e gjata prodhuar nga nje material PVC, ngjyre jeshile, jane te pa depertueshme nga uji.

Ngjyra :

Materiali : PVC

Rezistent ndaj ujit : PO



10. Mushama shiu, PVC



Ky produkt duhet te ofroi mbrojtje të plotë kundër shiut, te përshtatet në mënyrë perfekte dhe mund të vishet mbi rrobat në kohë me shi. Materialit te jete i fortë dhe elastik dhe rezistente. Te jene konform direktives 89/686/CEE. Te jete e kategorise se dispozitave te mbrojtjes individuale kundrejt fenomeneve atmosferike (EC-89/686 4.3d). Te përfshihet ne kategorine e pare dhe profesionale.

Materiali : PVC

Ngjyra :

Trashësia : 0.28mm.

11. Pantallona pune me shume xhepa

te jene te realizuar nga poli-pambuku cilesor, ka si vecori xhepa te shumte me zinxhire dhe pelhure te perforcuar ne zonen e uljes dhe ne gju.

Xhakete pune me shume xhepa

Kjo xhakete duhet te jete praktike dhe e forte. Xhepa te shumte, ne krahe, xhepa anesore, ne gjoks, xhep per personifikim, dhe doreza kyce velcro te rregullueshme.

Materiali: Pambuk/polyester

- Përmasa :
- Ngjyra :

12. Çizme pulumbari/peshkatari.

Duhet te jene sipas Direktives CE per mbrojtjen individuale 89/686/EEC dhe përmbush standardet evropiane EN ISO 20345:2011. Te jete e certifikuar nga SATRA TECHNOLOGY INTERTE Material sintetik dhe natyral sipas normative EN ISO 20345 për performancen dhe cilesine. Mbrojtja nga impakti godites deri ne 200 Joules Rezistenca ne penetrim (1100 neëtones) Konduktiviteti rezistenca maksimale 100 k Ω . Antistatike rezistenca nga 100 k Ω – 1000 m Ω .

III.1.4. Në shtojcën 9 “Sasia dhe grafiku i lëvrimit” të dokumentave standarde të procedurës së prokurimit objekt ankimi, nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar:

“Sasia e mallit që kërkohet:

	Emërtimi	Njësi	Sasi
1	Kominoshe pune	cope	136
2	Veshje pune pantallona & xhaket	pale	42
3	Cizme	Pale	
	Cizme te gjata	Pale	155
	Cizme te shkurtra	Pale	68
4	Mushama Shiu	cope	154
5	Çanta pune	cope	57
6	Maska mbrojtëse	cope	90
7	Dorashka meshini	Pale	40
8	Kaskete mbrojtëse	cope	28
9	Dorashka	pale	228
10	Jelek Fosforik	cope	208
11	Çizme pulumbari	pale	40
12	kepus pune	pale	7

Afatet e lëvrimit: Sasia e mallit objekt prokurimi duhet te levrohet, nga kontraktori, jo me vone se 10 (dhjete) dite nga nenshkrimi i kontrates”.

III.1.5. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

III.1.6. Komisioni sqaron se autoriteti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale të përcaktuara në dokumentat e tenderit, të tilla si mostra të mallit apo kataloge teknike kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike sikundër është kërkuar në këtë procedurë prokurimi. Nisur nga sa mësipër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, pretendimi i autoritetit kontraktor se mostrat e paraqitura të artikujve dhe materialeve nga operatori ekonomik ankimues, nuk janë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentat e tenderit qëndron, pasi për autoritetin kontraktor është e domosdoshme dhe e rëndësishme të vërtetohet që një operator ekonomik plotëson kriteret e kërkuara, për sa kohë ato janë në përputhje dhe në përputhje me përmasat dhe natyrën e objektit që prokurohet.

Nga dokumentacioni i paraqitur, rezulton se operatori ekonomik ankimues nuk është i aftë të ofrojë të gjitha produktet, sipas specifikimeve teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Mostrat - referuar edhe legjislacionit në fuqi- i shërbejnë autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar nga autoriteti kontraktor. Në rastin konkret nuk mund të vërtetohet se operatori ekonomik ankimues "Ferit Myftari" p.f, ka kapacitete për të ofruar produktet e kërkuar nga autoriteti kontraktor, sepse disa prej mostrave të paraqitura nga ankimuesi, siç janë veshje pune pantallona, xhaketa dhe çizme polumbari, nuk janë sipas specifikimeve teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor, gjë të cilën e ka pranuar dhe vetë ankimuesi, i cili ka pranuar të metat e produkteve të paraqitura, me anë të nënshkrimit pa rezerva të procesverbalit mbi hapjen e mostrave, datë 26.05.2017, mbajtur mes anëtarëve të KVO-së dhe 2 prej përfaqësuesve të operatorëve ekonomikë pjesmarrës në procedurën e prokurimit objekt ankimi.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues "Ferit Myftari" p.f nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet mbi arsyet e tjera të skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues "Ferit Myftari" p.f, Komisioni i Prokurimit Publik, referuar gjykimit mësipër në pikën III.1.6., gjykon se nuk do të merren në shqyrtim për ekonomi të procedurës administrative pasi, gjendja faktike dhe juridike e këtij operatori ekonomik do të vijojë të ngelet e skualifikuar edhe pas ankimit në KPP, duke mos pasur më interes të ligjshëm në lidhje me këtë procedurë prokurimi.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 "Për miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", të ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Ferit Myftari” p.f për procedurën e prokurimit “*Kërkesë për propozime*”, me Nr. REF-11777-05-09-2017, me objekt “Blerje rroba pune”, me fond limit 1.619.000 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 26.05.2017 nga autoriteti kontraktor, Ujësjellës-Kanalizime Vlorë ShA.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vazhdojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr.1059 Protokolli, Datë 06.06.2017

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Leonard Gremshi

Anëtar
Hektor Balluku

Anëtar
Kleves Janku

Anëtar
Odise Moçka

Kryetar
Evis Shurdha